



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

ЦЕНТАР ЗА УПРАВУВАЊЕ СО КРИЗИ
QENDRA PËR MENAXHIM ME KRIZA

PLANI PËR BARAZI GJINORE I QMK-së (2026–2028)

1. Hyrje dhe Angazhim

Qendra për Menaxhimin e Krizave (QMK) është e përkushtuar për integrimin e plotë të perspektivës gjinore në sistemin për parandalimin, paralajmërimin e hershëm dhe menaxhimin e krizave. Ky plan (2026–2028) është një përgjigje strategjike ndaj nevojës së identifikuar për përfshirje më të madhe të grave në sektorët operacionalë dhe në proceset vendimmarrëse, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Krizave.

2. Analiza e gjendjes (Subjekti i analizës)

- **Vendi i aktivitetit:** Sektori i Operacioneve dhe Koordinimit dhe Sektori E-112 (Shkup, Kumanovë, Shtip, Veles, Strumicë, Manastir, Ohër dhe Tetovë).
- **Problemi:** Numër i vogël i grave të punësuar në pozita operacionale (punë me ndërrime) dhe pjesëmarrje e pamjaftueshme aktive e grave në krijimin e politikave dhe planeve strategjike brenda Sistemit për Menaxhimin e Krizave (SMK).

3. Qëllimet Strategjike dhe Masat (2026–2028)

A. Balanca gjinore në udhëheqje dhe vendimmarrje

- **Qëllimi:** Të rritet pjesëmarrja e grave në organet drejtuese dhe në pozitat ku merren vendime për menaxhimin e krizave.
- **Masa:** Vendosija e vendeve të synuara (synimeve në përqindje) për përfaqësimin e grave në grupet e punës përgjegjëse për hartimin e planeve operacionale për përgjigje ndaj krizave.

B. Integrimi i dimensionit gjinor në punën operacionale

- **Qëllimi:** Zbatimi i perspektivës gjinore gjatë krijimit të masave për kushte emergjente në nivel qendror dhe lokal.
- **Masa:** Trajnime specifike për punonjësit operacionalë lidhur me nevojat e ndryshme të burrave dhe grave në situata krize.

C. Trajnimi dhe ngritja e vetëdijes (Tregues gjinor)

- **Indikator:** Numri i grave dhe burrave të trajnuar të punësuar në QMK për pjesëmarrje aktive në planifikim dhe koordinim.
- **Aktiviteti:** Realizimi i sesioneve trajnuese modulare për njohjen e paragjykimëve të pavetëdijshme gjinore brenda sektorit të sigurisë.



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

ЦЕНТАР ЗА УПРАВУВАЊЕ СО КРИЗИ
QENDRA PËR MENAXHIM ME KRIZA

4. Korniza buxhetore dhe Financimi (2026–2027)

Duke qenë se buxheti bazë i QMK-së për vitin 2026 nuk parashikon mjete të mjaftueshme, zbatimi do të bëhet përmes donacioneve dhe partneriteteve ndërkombëtare.

| Viti | Vendi i trajnimit | Mjetet e nevojshme (Denarë) |
|----------|--------------------------|-----------------------------|
| 2025 | Shkup dhe Kumanovë | 300,000 |
| 2026 | Ohër, Strumicë dhe Veles | 600,000 |
| 2027 | Shkup dhe Kumanovë | 300,000 |
| Gjithsej | | 1,200,000 |

5. Mekanizmat e Mbështetjes Institucionale

Për zbatimin e suksesshëm të Planit për Barazi Gjinore, QMK do të krijojë strukturat e mëposhtme:

- **Koordinatori për Barazi Gjinore:** Një anëtar i emëruar i stafit me mandat 3-vjeçar.
- **Grupi i Punës:** I përbërë nga të paktën 5 anëtarë nga stafi administrativ dhe operacional.
- **Personi i besuar:** Për raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore ose ngacmimit në vendin e punës.

6. Observimi dhe Raportimi

- **Raporti vjetor:** Përgatitja e një raporti publik mbi progresin e indikatorëve gjinorë.
- **Të dhënat:** Mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë për të gjithë punonjësit në 8 qendrat rajonale.
- **Mbikqyrja:** Plani do të rishikohet çdo tre vjet në bazë të rezultatet e trajnimit dhe ndryshimet në strukturën e të punësuarve.

Përfundim: Përmes këtij Plani, Qendra për Menaxhimin e Krizave po transformohet në një institucion gjithëpërfshirës që njih kapacitetet homogjene të grave dhe burrave si faktor kyç për një përgjigje më efikase ndaj krizave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

ЦЕНТРА ЗА УПРАВУВАЊЕ СО КРИЗИ
QENDRA PËR MENAXHIM ME KRIZA

Deklarata Buxhetore e Përgjegjshme Gjimore

| Seksioni | Përmbajtja |
|--|--|
| 1. Emri i Propozuesit | i Menaxhimi i Krizave - Sektori i Operacioneve dhe Koordinimit dhe Sektori E-112 |
| 2. Emri i Propozimit | i Përforcimi i kapaciteteve të Qendrës për Menaxhimin e Krizave dhe Sistemit për Menaxhimin e Krizave |
| 3. Akt nga i cili buron lënda e analizës | Në përputhje me të Ligjin për Menaxhimin e Krizave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 29/05, 36/11, 41/14, 104/15, 39/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 215/21) |
| 4. Qëllimi i propozuar i lëndës për analizës | i Misioni i Qendrës ofron sigurimin e një niveli konstant të komunikimit, koordinimit, konsultimit dhe shkëmbimit ndërinstitucional të të dhënave, në funksion të gatishmërisë dhe ndërveprueshmërisë së subjekteve që janë pjesë e sistemit për parandalimin dhe paralajmërimin e hershëm të rreziqeve dhe kanosjeve që mund të shkaktojnë fatkeqësi dhe situata krize të caktuara, si dhe ofrimin e një përgjigjeje të koordinuar dhe tejkalimin e pasojave të ngjarjeve dhe dukurive që mund të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, të mirat natyrore, materiale dhe kulturore, si dhe sigurinë e përgjithshme të Republikës. Zbatimi i perspektivës gjimore në punë dhe krijimi i masave dhe programeve gjatë kushteve emergjente dhe situatave të krizës në nivel qendror dhe lokal. Mekanizma të krijuar për integrimin e politikave të barazisë gjimore në situata emergjente dhe krize. |



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

ЦЕНТАР ЗА УПРАВУВАЊЕ СО КРИЗИ
QENDRA PËR MENAXHIM ME KRIZA

| Seksioni | Përmbajtja |
|---|--|
| 5. Përshkrim i shkurtër i lëndës të propozuar të analizës | Ligji për Menaxhimin e Krizave rregullon punë operacionale 24/7 në Qendrën për Menaxhimin e Krizave në 8 rajone si Qendra Kryesore Rajonale (Shkup, Kumanovë, Shtip, Veles, Strumicë, Manastir, Ohër dhe Tetovë). Sipas Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sektorin e Operacioneve dhe Koordinimit dhe Sektorin E-112, ka punonjës operacionale përgjegjës për marrjen e thirrjeve emergjente dhe punonjës operacionale për komunikim dhe koordinim me subjektet në Sistemin e Menaxhimit të Krizave. Në pozitat ku janë vendosur punë në ndërrime, ka punsuara femra, ndonëse numri i tyre nuk është shumë i madh. Një situatë e ngjashme ekziston edhe me punonjësit operacionale nga subjektet e tjera pjesëmarrëse në sistem, ku numri i operatoreve femra është gjithashtu i vogël. Problemi nuk qëndron vetëm në numrin e grave të punësuar, por edhe në pjesëmarrjen aktive të grave në krijimin e politikave, planifikimin, vendimmarrjen, etj., brenda Sistemit të Menaxhimit të Krizave. |
| 6. Indikatorit gjinor | Ngritja e vetëdijes tek gratë e punësuar në subjektet që janë pjesë e Sistemit të Menaxhimit të Krizave lidhur me pjesëmarrjen aktive në planifikim, vendimmarrje dhe koordinim të aktiviteteve për paralajmërim të hershëm, parandalim dhe gjatë situatave të krizës në vend. |

7. Vlera e treguesit gjinor

| Viti t | Viti t + 1 | Viti t + 2 | Viti t + 3 | Viti t + 4 | Viti t + 5 |
|--------|------------|------------|------------|------------|------------|
| | | | | | |

8. Buxheti i propozuar për realizimin e lëndës së propozuar të analizës

| Viti t | Viti t + 1 | Viti t + 2 | Viti t + 3 |
|--------|------------|------------|------------|
| | | | |

9. Ndërlidhja me: Programin buxhetor (kodi dhe emri) dhe nënprogramin buxhetor (kodi dhe emri)



Влада на Република Северна Македонија
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

ЦЕНТАР ЗА УПРАВУВАЊЕ СО КРИЗИ
QENDRA PËR MENAXHIM ME KRIZA

Nga Buxheti i përgjithshëm i Qendrës për Menaxhimin e Krizave i planifikuar për vitin 2025, nuk ka mjete të mjaftueshme për realizimin e aktivitetit. Për të zbatuar aktivitetin, do të bëhen përpjekje për të siguruar mbështetje/donacione nga organizatat ndërkombëtare.

Buxheti i parashikuar për realizimin e sesioneve trajnuese është si vijon:

- **Për vitin 2025:** Zhvillimi i trajnimeve në Shkup dhe Kumanovë – kërkohet gjithsej 300,000 MKD;
- **Për vitin 2026:** Zhvillimi i trajnimeve në Ohër, Strumicë dhe Veles – kërkohet gjithsej 600,000 MKD;
- **Për vitin 2027:** Zhvillimi i trajnimeve në Shkup dhe Kumanovë – kërkohet gjithsej 300,000 MKD.

u.d.Drejtor
Muhamet Ali

